

amnesty international

REPUBLIKA FEDERALE E
JUGOSLLAVISË

***KRIZA E TË DREJTAVE TË
NJERIUT NË KRAHINËN E
KOSOVËS***



**Seria e Dokumentave A: Ngjarjet deri me
Qershorit 1998**

**#3: Vdekjet gjatë
arrestimeve, tortura
dhe keqtrajtimi**

Publike
AI Index: EUR 70/34/98/ALB

QERSHOR 1998



Rreth dokumenteve kësaj serie

Prej qershorit 1998, Bashkësia Ndërkombëtare po shikon derisa situata e sigurisë në krahinën e Kosovës të Republikës Federale të Jugosllavisë po keqësohet me shpejtësi dhe madje edhe respekti minimal për të drejtat e njeriut është zvogëluar. Operacionet e fundit ushtarako-policore serbe, edhe pse nga larg duken të drejtura kundër opozitës së armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ato përsëri kanë sjellur në vdekjen e qindra civilëve, prej të cilëve shumë janë dukshëm rezultat i sulmeve të qëllimta dhe pa dallim. Sulmet mbi civilët kanë qenë një nga arsyet pse mijëra njerëz janë larguar nga shtëpitë e tyre. Anëtarët e UÇK-së kanë qenë gjithashtu përgjegjës për keqpërdorimin e të drejtave të njeriut.

Zhvillimet e qershorit të vitit 1998 nuk mund të izoloohen nga shkeljet e shumta të drejtave të njeriut që në Kosovë ndodhin prej më shumë se një dekadë. Gjatë gjithë kësaj kohe Amnesti Interneshënëll ka dokumentuar dhe ka bërë fushatë kundër modelit sistematik të dhunimit të drejtave të njeriut në krahinën e Kosovës; përfshirë ketu torturën dhe keqtrajtimin nga policia, vdekjet gjatë arrestimeve nga policia dhe gjykimet e padrejta të burgosurve politik. Mungesa e zgjidhjes së duhur të këtyre problemeve si dhe shkeljet tjera të të drejtave themelore të njeriut në krahinë duhet të numërohen si burime të frustrimeve dhe dëshprimet që ka kulmuar deri në konfliktin e tanishëm.

Përveç studimeve të vazhdueshme, punës me mediat, iniciativave e fushatave të anëtarëve të saj në gjithë botën, Amnesti Interneshënëll, për t'iu përgjigjur ngjarjeve të qershorit 1998, në serinë e raportimeve të saj hulumton përtej titujve të lajmeve ditore dhe vazhdon shqyrtimin e saj të hollësishëm dhe në detaje të modeleve të dhunës shumëvjeçare në krahinën e Kosovës. Në këtë seri janë publikuar njëkohësisht katër dokumente:

#1: *Hyrje: Kriza që pritej të ndodhte (AI Index: EUR 70/32/98/ALB)*. Një analizë e përmbledhur e shkaqeve të krizës së sotme dhe rekomandimet që i bën Amnesti Interneshënëll komunitetit ndërkombëtar, autoriteteve jugosllave dhe UÇK-së.

#2: *Dhuna në Drenicë (AI Index: EUR 70/33/98/ALB)*. Një analizë e hollësishme e vrasjeve arbitrare dhe ekzekutimeve pa gjykim gjatë operacioneve policore dhe ushtarake në periudhën shkurt-mars 1998 në zonën e Drenicës (para ngjarjeve të qershorit) dhe raportimet e keqpërdorimit të drejtave të njeriut nga UÇK-ja.

#3: *Vdekjet gjatë arrestimeve, tortura dhe keqtrajtimi (AI Index: EUR 70/34/98/ALB)*. Një vëzhgim i përdorimit të gjërë të torturës dhe keqtrajtimin ndaj të arrestuarve dhe demonstruesve në rrugë përfshirë ketu edhe dëshmitë e hollësishme të viktimave të fundit të arrestit, si dhe dëshmitë fotografike gjatë vitit 1998.

#4: *Gjykimet e padrejta dhe abuzime të proceseve në vijim (AI Index: EUR 70/35/98/ALB)*. Një vëzhgim i dështimeve të vazhdueshme në administratën e drejtësisë gjatë rasteve politike, duke përfshirë këtu edhe hollësitë e katër gjykimeve politike gjatë viteve 1997-98.

Keto raportime janë bazuar kryesisht në informacionin e mbledhur gjatë një mision të Amnesti Interneshënëll në Republikën Federale të Jugosllavisë në mars të vitit 1998 për të hetuar shkeljet e drejtave të njeriut duke përfshirë këtu edhe ato të kryera në kontekstin e operacioneve policore dhe ushtarake në zonën e Drenicës dhe mbi informacionin e fundit të marrë prej përfaqësuesve të Amnesti Interneshënëll në teren gjatë qershorit 1998. Gjithashtu informatat janë marrë edhe nga vëzhguesit lokal të drejtave të njeriut në Kosovë dhe Beograd, nga juristët vendas, gazetarët e huaj dhe vendas dhe individë të tjerë. Amnesti Interneshënëll është mirënjohëse për ndihmën që i është ofruar nga këto burime.

Seritë e mëtejshme të raportimeve që janë duke u përgatitur do të shqyrtojnë situatën e drejtave të njeriut në Kosovë prej qershorit të vitit 1998.

Fotografia në kopertinë: Studentja shqiptare etnike Vlora Maliqi, fytyra e të cilës paraqet shenjat e të rrahurave që ajo pësoi nga duart e policisë mbasi mori pjesë në një demonstratë në Prishtinë me 18 mars 1998. © Amnesty International.

REPUBLIKA FEDERALE E
JUGOSLLAVISË

*Kriza e të Drejtave të Njeriut ne Krahinën e
Kosovës*

Vdekjet gjatë arrestimeve, tortura dhe keqtrajtimi

Vdekjet e paligjshme gjatë arrestimeve.

Deri ne mars të vitit 1998 dhe kryerjes së operacioneve policore ne Drenicë (të cilat jane përshkruar ne dokumentin shoqërues *Dhuna në Drenicë*, #2 në këtë seri, AI Index: EUR 70/33/98/ALB) shumica e provave të vrasjeve të paligjshme nga policia lidhej me vdekjet gjatë arrestimeve si pasojë e torturës dhe keqtrajtimit (bile edhe vrasjeve) të viktimave gjatë hetimit nga policia. Keshilli per Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ, Organizata kryesore etnike shqiptare e drejtave të njeriut në Kosovë) raportoi pesë vdekje të tilla në vitin 1997. Dy nga keto raste janë përshkruar më poshtë sipas provave të para nga Amnesty Interneshënëll.

Jonuz Zeneli ishte arrestuar më 30 prill 1997 dhe ishte në grupin e 21 shqiptarëve etnik që ishin paditur për "terrorizëm" (shih gjithashtu "Gjyqi i Nait Hasanit dhe 16 të tjereve" në dokumentin shoqërues *Gjyqe të padrejta dhe abuzime të proceseve*, #4 në këtë seri, AI Index: EUR

70/35/98/ALB). Më 16 tetor 1997, pak para hapjes së gjykimit më 27 tetor, Jonuz Zeneli vdiq në spitalin e Burgut Qendror të Beogradit. Ai ishte transferuar atje nga spitali i burgut të Lipjanit (Kosovë) ku iu ishte ankuar familjarëve për dhembje të veshkave si pasojë e torturave dhe keqtrajtimit në burg. Të afermit e tij nuk ishin informuar nga policia për shkaqet e vdekjes se tij. Një certifikatë e lëshuar nga spitali i burgut bënte të ditur se ai kishte vdekur nga kanceri i mushkërive që kishte migruar në pjesë të tjera të trupit të tij. Megjithatë fotografitë e trupit të tij tregojnë shenja të torturës ose keqtrajtimit dhe rrethanat e theksojnë këtë qoftë si shkak ose faktor ndihmes i vdekjes se tij.

Më 27 nëntor 1997 **Ismet Gjocaj** u qellua dhe u vra nga policia në rrethana të diskutueshme në Irzniq, fshat afër Deçanit. Sipas raportimeve që iu përcollën shtypit nga policia, ai kishte marrë pjesë në një sulm të armatosur kunder stacionit të policisë në atë fshat dhe ishte vrarë nga policia duke kthyer zjarr. Një polic ishte lajmëruar i vrarë në këtë sulm dhe një tjetër ishte plagosur. Megjithatë, shpjegimet e policise për se Ismet Gjocajt kishte marrur

pjesë në këtë sulm nuk duken të besushme. Më 25 nëntor, Ismet Gjocaj i bëri një deklaratë deges lokale të KMDLNj-së në Deçan në të cilën ai pohonte se më 21 nëntor një patrullë policie kishte ndaluar atë dhe një shqiptar tjetër derisa ata po prisnin dru afer kufirit sh-qipëtar dhe iu

ishte kërcënuar. Ai gjithashtu deklaroi se ishte përcjellur në shtëpinë e tij e cila ishte bastisur, dhe se ai dhe vellau i tij u mbajtën në arrest për pak kohë dhe me pas ju thanë të raportoheshin në polici më 25 nëntor (ditën që ai dha deklaratën).

Ka prova të forta që ai i ishte lajmëruar policisë dhe ishte në burg atë natë kur kishte vdekur dhe kur kishte ndodhur sulmi i lajmëruar në stacion të policisë. Një patolog ligjor i konsultuar nga Amnesty Interneshënëll, që ekzaminoi fotografitë e trupit të Ismet Gjocaj, arriti në përfundim se trupi kishte maviosje të shumta e të fresketa, kryesisht në shpinë, të



• Trupi i Ismet Gjocajt, i vrarë nga policia më 27 nëntor 1997

ndenjura dhe në krah. Maviosjet tregojnë që ka qenë rrahur me shkopë policie ose objekte të ngjashme me to. Akoma më serioz është fakti se të mavijosurat apo plagët janë kryer pas shpine. Amnesty Interneshënëll beson se shpjegimi më i mundshëm për vdekjen e Ismet Gjocaj është se ai ishte arrestuar në kohën e sulmit ndaj stacionit të policisë dhe është ekzekutuar në menyrë të paligjshme, ka mundësi të jetë si hakmarrje ndaj vdekjes dhe plagosjes së oficerëve të policisë të lajmëruara atë natë.

Tortura dhe keqtrajtimi

Duket se tortura dhe keqtrajtimi kanë qenë deri me sot shkeljet me të shpeshta të të drejtave të njeriut të kryera nga policia në krahinën e Kosovës. Që nga viti 1990 shqiptarët etnik e kundërshtuan regjimin Federal duke krijuar institucionet e tyre paralele dhe kercenimi i policisë, duke përfshirë ketu edhe keqtrajtimin fizik, ka qenë drejtuar me tepër ndaj atyre që kanë qenë të inkuadruar në një mënyrë ose tjetër në keto institucione paralele. Viktimat shpesh ishin aktivistë politikë, gazetarë, aktivistë të drejtave të njeriut ose mësues e studentë në institucionet paralele mesimore. Megjithatë, viktima ishin edhe shumë njerëz që nuk ishin aktivë në këto institucione paralele dhe keqtrajtimi i tyre mund të përshkruhet si "rutinë". Në përgjithësi rastet me të rënda të keqtrajtimit ku ato arrinin deri në torturë kanë ndodhur në stacionet e policisë.

Amnesti Interneshënëll ka dokumentuar keqtrajtimit në të kaluarën, si për shembull shikoni ato raste të përmbledhura në raportin *Dhuna policore në krahinën e Kosovës - viktimat* (AI Index: EUR 70/16/94, shtator 1994). Lidhur me zhvillimet e kohëve të fundit shqetësimi i Amnesti Interneshënëll në keto zona është rritur. Kohët e fundit qindra shqiptarë etnik janë keqtrajtuar gjatë demonstratave paqësore në lidhje me konfliktin për arsim (shikoni më poshtë), dhe akoma më rishtazi gjatë demonstratave kundër dhunës policore në Drenicë.

Tortura dhe keqtrajtimi gjatë bastisjeve për armë.

Skenarë të përbashkët për këtë tip keqtrajtimi janë bastisjet e shtëpive nga policia në fshatra ku ata pretendonin se kerkonin armë të fshehura. Këto kontrollime u benë ngjarje të përditshme pas shpërthimit të konfliktit të armatosur në pjesë të tjera të ish Jugosllavise gjatë vitit 1991. Të gjitha armët të mbajtura në menyrë legale apo ilegale konfiskoheshin sapo gjendeshin. Keqtrajtimi i policisë ishte i përhershëm, pavarësisht nëse gjendeshin armë ose jo, dhe kur nuk gjendej ndonjë armë atëherë i urdhëronin njërezit ta blenin atë dhe me pas ta dorëzonin. Meshkujt merreshin shpesh në polici pavarësisht a u gjendej arma a jo, dhe gratë e familjes shpesh keqtrajtoheshin ose kanoseshin nga sjellja e dhunshme e policëve.

Shumë nga zonat ku bastisjet për armë ishin më të theksuara si për shembull zona në kufi me Shqipërinë, janë tani skena të sulmeve me intensive dhe luftimeve me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Kërkimet e tilla të armëve, ndoshta tani janë më të rralla, por janë zëvendësuar me skenarë më serioz, sikurse ai i Likoshanit ku policia ndoqi njërezit e armatosur dhe aksioni i tyre përfundoi në ekzekutime të paligjishme (shihni dokumentin shoqëruar *Dhuna në Drenicë*, #2 në këtë seri, AI Index: EUR 70/33/98/ALB). Kërkimi i armëve zë vend të rëndësishëm në kontekstin e stuatës së sotme në Kosovë.


Një shembull është dhe arrestimi dhe torturimi i **Qamil Xhemajlit** në orët e

para të 31 janarit 1997. Incidenti u dokumentua nga një delegat i Amnësti Interneshënëll në Kosovë në qershor të vitit 1997. Qamil Xhemajli dhe anëtarët e tjerë të familjes se tij ishin vënë në shenjështër që më parë nga policia; ndoshta pasi ai dhe anëtarët e tjerë të familjes se tij të madhe kishin qenë të burgosur më parë për shkaqe politike dhe katër prej tyre ishin larguar nga vendi. Ai i dha Amnësti Interneshënëll të dhëna me shkrim dhe me gojë duke deklaruar se

“... policia rrethoi shtëpinë tonëata filluan të thyejnë derën dhe kështu unë e e hapa atë menjëherë. Ata menjëherë më pyetën nëse unë isha Qamili dhe më lidhën prangat. Më pyetën se ku i kisha fshehur materialet ilegale dhe ku i kisha fshehur armët që ishin përdorur për të vrarë polic. Kur unë mohova se nuk mbaja asnjë nga këto, ata më goditën me grusht në fytyrë dhe në trup. Kërkuan në raftet e librave dhe shkatërruan mobiljet e shtëpisë. Ata gjetën vetëm fotografi të familjes, letra nga burgu dhe disa kaseta magnetofoni me këngë - asgjë tjetër. Më pas ata me shpien në shtëpinë e vëllaut tim Bajrushit që është në burg duke kryer dënimin. Atje ishin vetëm gruaja e tij Shahadija me dy fëmijë të vegjël. Pasi kontrolluan shtëpinë morën me vete disa fotografi të familjes. Më pas me çuan në fushë ku me pyetën se kujt i përkiste toka dhe pyjet dhe çfare ishte fshehur atje. Më vonë më përcollën në shtëpi dhe filluan të me gjuajnë me grushta në fytyrë dhe përsëri më kërkuan të dorëzoja dokumentet dhe armët. Policët tjerë kërkonin në oborr dhe në pyll.”

Qamil Xhemajli pastaj u lidh me zinxhir në një dollap metalik në stacionin e policisë në Ferizaj dhe u rrah nga policia duke u munduar ta detyronin të pranonte se kishte vrarë një oficer policie, se mbante armë dhe ishte anëtar i një organizate të fshehtë. Pas një ditë e gjysmë ai u transferua në burgun e Gjilanit dhe u rrah përsëri nga policia para se të lirohej. Ekzaminimi i mjekut, dy javë më vonë, vërtëtoi se kishte të thyer një bri dhe ende kishte të mavijosura në trup dhe në kokë. Keto raste të torturave gjithashtu kanë efekt traumatizues edhe në të afërmit e viktimave. Nëna e Qamil Xhemajlit tha: “Kur erdhi në shtëpi mezi ecte. Ishte gjysëm i vdekur...si një hije, nuk mund ta njihje. Fëmijët nuk mund t'i afroheshin, iknin prej tij”. Vetë Qamil Xhemajli e interpretonte këtë dhe vizitat tjera policore si kërcënim ndaj familjes së tij për t'i detyruar të iknin, duke thënë “ata me thanë njëherë: ‘Çfarë bën ti ketu, shko në Zvicër ose të vrasim. Ti je budalla ose i çmendur që rrin në Kosovë.’” Thuaj 100 veta u arrestuan në të njëjtën kohë me Qamilin. Shumica i'u nënshtrua torturave apo gjykimeve të padrejta që janë përshkruar në dokumentin *Gjykime të padrejta dhe keqpërdorime të proceseve në vazhdim*, #4 në këtë seri AI Index: EUR 70/35/98/ALB.

Shembuj të torturimit dhe keqtrajtimit “rutinë”



● Ferdian Ibërdemaj


Sipas një deklarate të KMDLNj-së, rreth orës 11 të mbrëmjes së 2 shtatorit 1997, policë me veshje civile shkuan në shtëpinë e 16 vjeçarit **Ferdian Ibërdemaj** në Pejë duke e akuzuar atë se kishte vjedhur një biçikletë. Ai u nxorr jashtë qytetit në kodrat afër fshatit Brestovik, u mbajt atje disa orë dhe u rrah para se të lihet aty. Ekzaminimi i fotografive të plagëve të tij nga patologu konfirmoi se plagët e pranishme ishin pasojë e rrahjes me shkopa policie të përkulshëm ose kauçuku.

Më 12 prill 1998, 38 vjeçari **Soko**

Rugovac, një mysliman nga qyteti Rozhaj i Malit të Zi, 40 km në veri të Pejës, u ndalua nga policia në Pejë derisa po merrte një taksi nga stacioni i autobusi për në shtëpinë e tezes se tij. Sipas të dhënave që ai i dha më pas policisë së Malit të Zi dhe shtypit, kuptohej se ai ishte urdhëruar të dilte jashtë taksit pa asnjë arsye të qartë, ishte shpër në stacionin qendror të policisë dhe drejt në bodrum.

Ata më së pari e pyetën se a ka ardhur në Pejë që të merrte pjesë në demonstratat e shqiptarëve etnik që ishin të nësermen dhe nëse kishte ardhur të blente vota për Milo Djukanoviq-in [në zgjedhjet parlamentare të Malit të Zi që ishin mbajtur në maj]¹. Kur ai pranoi se kishte votuar për Djukanoviq-in në zgjedhjet presidenciale, dy oficerë të policisë damkosën germat MILO në gjoksin e tij me hekur të nxehtë kallaj, prenë viza në gjoksin e tij me thikë dhe e goditën me grushta e shpulla (shih fotografinë në faqen tjetër). Pas këtij incidenti Ministria e Brendshme e Malit të Zi i lëshoi një protestë ekuivalences se saj sërbe duke i bërë thirrje të ndërmerre masa kundër policëve të përzier në këtë ngjarje. Gazeta e Beogradit *Vreme* raportoi më 25 Prill që stacioni i policisë së Pejës kishte deklaruar se e gjithë ngjarja ishte shpikur nga policia e Malit të Zi.

¹ Milo Djukanoviq është presidenti i Malit të Zi që u zgjodh në dhjetor të vitit 1997 dhe është në kundërshtim me autoritetët Serbe dhe Federale dhe në veçanti me Presidentin Federal dhe ish Presidentin Serb Slobodan Millosheviq.



● Soko Rugovac, me plagët e shkaktuara nga policia

Edhe pse rastet e tilla të gjymtimit janë të rralla krahasuar me format e tjera të torturave apo keqtrajtimit, KLN-ja raportoi një rast tjetër të njëjtin muaj. **Arsim Krasniqi** u lajmëruara i torturuar nga policia më 30 Maj 1998 derisa kryente punën e tij si pastrues rrugësh në Prishtinë. Në fillim ai u morr në pyetje rreth UÇK-se dhe filluan ta shkelmojnë dhe ta rrahin me kopaçe. Rrahja vazhdoi në stacionin e

policisë ku ai u lidh me zinxhirë në radiatorë, ndërsa në gjoksin e ti, me thikë gdhendën një kryq.

Keqtrajtimet gjatë demonstratave

Në tetor të vitit 1997 udhëheqësit e Unionit të Pavarur të Studentëve të shqiptarëve etnik nga Universiteti paralel i Prishtinës filluan një seri demonstratash paqësore që kërkonin mundësinë e hyrjes në ndërtesat (shtetërore) të universitetit. Demonstratat e para që u mbajtën më 1 tetor në të gjitha qytetet e Kosovës duke përfshirë njerëz të të gjitha moshave ashtu si dhe studentë, u shtypën me dhunë nga policia duke lënë qindra të rrahur ose të plagosur në mënyra të ndryshme. Edhe pse demonstratat tjera në fund të Tetorit vazhduan pa dhunë policore, edhe qindra demonstrues u plagosën kur policia i shpërndau demonstratat e fundit të dhjetorit.


Vrasjet në Drenicë sollën përsëri mijëra demonstrues në rrugët e shumicës së qyteteve në fillim të marsit 1998. Gjatë shpërndarjes së demonstratave të tilla, më 2 mars, policia përdori forcë të tepruar ndaj demonstruesve, shumica e të cilëve, sipas burimeve të sigurta, silleshin në mënyrë paqësore. Si pasojë e kesaj qindra njerëz u plagosën. Demonstratat që pasuan me pas, së paku në Prishtinë, vazhduan të shtypeshin pa dhunë. Por në vende të tjera demonstratat u shtypën me dhunë ku incidenti më serioz ndodhi në Pejë më 18 Mars 1998 ku policia hapi zjarr kundër demonstruesve; incidenti i përshkruar më poshtë. Edhe në rastet kur policia lejonte mbajtjen e demonstratave, njerëzit keqtrajtoheshin kur përpiqeshin të hynin në qytete për t'iu bashkangjitur demonstratave ose kur shpërndaheshin

dhe ktheheshin në shtëpi. Shembuj të tillë përshkruhen më poshtë.

Rreth orës 11 të paraditës, më 18 mars, shqiptarët etnik demonstruan në Prishtinë. Në të njëjtën kohë serbët nga e gjithë Serbia filluan të vinin për një demonstratë që do të mbahej atë pasdite si kundërshtim i kërkesave të shqiptarëve etnik. Atmosfera në qytet atë ditë ishte shumë e tendosur. Policia nuk e ndërpreu demonstratën e mengjesit por në vend të kesaj rrahu apo keqtrajtoi disa nga demonstruesit shqiptarë kur ata po shpërndaheshin. Studentja 19 vjeçare **Vlora Maliqi** ishte mes viktimave kur policia u afrua kundër një grupi të vogël të studentëve afer Fakultetit Filozofik të Universitetit shtetëror. Shokët që ishin me të arritën t'i shpëtonin policisë por megjithë përpjekjet e një shoku për ta ndihmuar, Vlora u rrëzua dhe u rrah rëndë. Ajo i deklaroi Amnesti Internashënëll: "Gjashtë policë me rrahën dje, ata më goditën në çdo vend. Me gjuajtën me shqelma në të gjithë trupin, me tërhoçen zvarrë e më shkullën flokët. Më rrotulluan që të me godasin në shpinë dhe pastaj në stomak".

Vlora Maliqi i tregoi delegatëve të Amnesti Internashënëll maviosjet në fytyren e saj (shikoni fotografinë në kopërtinë), shpinë, këmbë dhe krah.

Në anën tjetër të qytetit **Naser A.** (28), i papunë, po kthehej gjithashtu në shtëpi. Ai u ndalua nga dy policë, nëndërkohë derisa po kthehej nga një demonstratë në shtëpi së bashku me të tjerët dhe u shpie në një shkollë ku u rrah me shkop policor. Kur u intervistua dy ditë



● Naser A., me hematoma që shihen qartë, të shkaktuara nga rrahje e policisë

ndaluar dhe rrahur nga policia edhe kur kanë hyrë në qytet për të marrë pjesë në demonstrata, edhe kur janë shpërndarë nga ato. Një prej burrave u pa se kishte vështirësi në ecje për shkak të plagëve.

më vonë nga Amnesti Internashënëll, ai akoma kishte vështirësi në ecje. Shenjat e rrahjes ishin të qarta në të gjithë trupin por më dukshëm në shpinë ku kishte shenjat karakteristike të rrahjes me objekte të topitura. Ai deklaroi se rrahja kishte zgjatur mes 20-25 minutave dhe është ndërprerë vetëm kur drejtori i shkollës hyri brenda. Më pas ai u lëshua të shkoj i shoqëruar me disa goditje të tjera në kokë.

Më 19 mars delegatët e Amnesti Interneshënëll vunë re se demonstratat në Mitrovicë, që u mbajtën në qendër të qytetit dhe që ishin krejtësisht paqësore, u vëzhguan nga policia në distancë pa ndërhyrje. Megjithatë, para dhe pas demonstratave, Amnesti Interneshënëll intervistoi katër burra që deklaruan se ishin

Gjuajtja me armë dhe rrahja e demonstruesve në Pejë më 18 Mars 1998.

Më 18 Mars mijëra shqiptarë etnik u përpoqën të demonstironin në Pejë. Shumica e tyre vinin në qytet nga fshatrat përreth e sidomos nga pjesa lindore. Policia bllokoi rrugën afer linjës hekurudhore në pjesën lindore të qytetit dhe një turmë e madhe demonstruesish që donin të hynin në qytet nga fshatrat u mblodhën aty. Rreth orës 11 të paraditës **Qerim Muriqi** (50 vjeçarë) u vra nga një plumb i shtënë drejt turmës. Dëshmitarët e intervistuar nga Amnesti Interneshënëll besonin se është shtier nga një bllok i afërm banesash, por

ata nuk e panë gjuajtësin vetë. Pas vrasjes se Qerim Muriqit turma u shqetësua se tepërmi dhe në një moment disa pjesëtarë të turmës filluan të hedhin gurë në vijën e policëve që po i bllokonte. Policia filloi të shtiej në turmë duke përdorur zjarr automatik dhe të shtëna të vetme, megjithëse sipas disave mund të jetë që në fillim të kenë shtënë në ajër. Kur filluan të shtënat, shumica e turmës u përpoq të ikte por shumë u kapën dhe u rrahën nga policia. Përvoja e tyre është e përshkruar më poshtë në sektorin e keqtrajtimit. Më së paku pesë vetë pësuan plagë nga plumbat.

Sipas shpjegimeve të dëshmitarëve të incidentit, të cilat Amnesti Interneshënëll i mori tre ditë pas incidentit, nuk mund të gjendet asnjë justifikim për përdorimin e zjarrit ndaj demonstruesve nga ana e policisë. Është e qartë se ata duhet të kishin pasur mundësi të përdorin metoda të tjera se sa përdorimin e zjarrit për të kontrolluar turmën atëherë kur disa pjesëtarë kanë filluar të gjuajnë me gurë. Principi themelor i Kombeve të Bashkuara për Përdorimin e Forcës dhe Armëve të Zjarrit nga Nënpunësit e Zbatimit të Ligjit vendos kufizime në përdorimin e armëve të zjarrit duke theksuar: "Nënpunësit e Zbatimi të Ligjit nuk duhet të përdorin zjarrin kunder personave përveç në raste të vetmbrojtjes apo në mbrojtje të të tjerëve prej rrezikut të dukshëm vdekjeprures apo plagosjes serioze, për të ndaluar kryerjen e një krimi serioz që nënkupton rrezik të madh për jetë, për të arrestuar personat që paraqesin rrezik të tillë dhe e rezistojnë autoritetin e tyre,

ose të parandalohet ikja e tij ose asaj, por vetëm atëherë kur për të arritur këto objektiva, masat më pak ekstreme janë të pamjaftueshme. Në çdo rast, përdorimi i vetëdijshëm, vdekjeprurës i armëve të zjarrit duhet të bëhet vetëm atëherë kur është i paevitueshëm, me qëllim që të mbrohet jeta." (Artikulli 9)

Amnesti Interneshënëll ka vënë re që policia rregullisht vendos snajperë në vende të caktuara dhe me avantazh gjatë demonstratave. Ajo çka është e qartë në çdo rast është se autoritetet duhet më së paku të hetojnë rrethanat e vrasjeve dhe plagosjeve të demonstruesve dhe të vënë përpara përgjegjësisë të gjithë përgjegjesit e shkeljes së standardeve ndërkombtare dhe ligjit kombtar për përdorimin e forcës vdekjeprurëse.

Delegatët e Amnesti Internashënëll të cilët vizituan Pejën tre ditë pas incidentit intervistuan tetë burra dhe katër gra që deklaruan se ishin rrahur (shumica prej tyre akoma kishin shenja të dukshme), katër burra që ishin plagosur dhe dëshmitarë të tjerë që konfirmuan detajet e të shtënave dhe rrahjeve. CDHRF-ja raportoi se atë ditë 97 persona ishin plagosur si pasoje e rrahjeve. Provat e mbledhura nga Amnesti Internashënëll vetëm në një pjese të qytetit tregojnë se ky numër paraqet një figurë të qartë të asaj që kishte ndodhur. Viktimat nuk u rrahën vetëm në afërsi të linjës hekurudhore ku policia ndaloi mbledhjen e demonstruesve por edhe në zonat përreth, përfshirë këtu edhe shtëpitë ku ata u strehuan. Në mes rrëfimeve më shqetësuese është ajo e nxënëses 16 vjeçare të quajtur

Merita, që na tregoi shenja në lëkurën e kokës dhe maviosje në këmbë, të cilat ajo tha se ishin pasojë e keqtrajtimit. Për Amnesti Internashënëll ajo rrëfeu:

“Ne u mblodhëm në pikën tonë të takimit dhe papritur na thanë të shpërndaheshim. Ne filluam të vraponim dhe ata që ishin pas nesh, kryesisht gra, u rrezuan. Unë rash gjithashtu dhe pothuajse e humba pasi nuk dija se çfare të bëja. Ata qellonin mbi ne me automatikë dhe me pas një djalë më erdhi afër dhe me tërhoqi. Më pas një djalë tjetër më mori dhe me shpuri në shtëpinë e tij. Unë u qetësova për pak kohë por pastaj ne arritëm të kuptonim se policët po vinin drejt shtëpisë. U mbyllëm në një dhomë dhe më pas pamë një burrë tjetër që hyri dhe mbylli derën kryesore. Por policët e shkatërruan portën dhe hynë në dhomën tonë. Ata ishin katër policë ndërsa ne ishim katër femra dhe një burrë që kishte arritur të ikte. Ishim nxënë në kurthë, kur filluan t'i rrahin të tjerët unë u fsheha pas një kolltuku. Isha vërtet e frikësuar. I nxorrën të tjerët përjashtë; nëndërkohë dy policë më drejtuan automatikët e tyre në kokë dhe më tahnë: “Ngritu!” Isha aq e frikësuar dhe u ngrita sepse ashtu duhet të beja. Ata me rrahën me fundin e një bastuni dhe pashë tek rrjedhte gjak prej meje...Pastaj gratë e shtëpisë më morën dhe me shpion në kuzhinë e unë u zvarrita pas derës. Ata po i rrihnin të tjerët duke i shtyrë përjashta e kur panë se unë mungoja thanë: 'Ishte një vajzë tjetër bjonde ketu'. Ata filluan të me kërkojnë kudo kur një polic i shëndoshë hapi derën dhe me pa që po fshihesha. Unë

i fola serbisht: 'Unë e di serbishten, të lutëm mos me godit. A ke femijë në shtëpi...nuk e sheh sa e re jam?' Ata më pyetën se sa vjeçare isha, unë u thashë se kisha gjashtëmbëdhjetë vjetë. Brenda një minute dikush bertiti: 'një, dy, tre, përjashta!' dhe ata u larguan. Megjithatë kur ai polic po iktë më goditi edhe njëherë rreth qafe dhe unë humba vetëdijen”.

Dëshmia e Meritës përkonte me të tjerat që tregonin të ngjarje të ngjashme të rrahjeve në rrugë apo në shtëpitë e njerëzve.

Rekomandimet e Amnesti Interneshënëll

Autoriteteve Serbe dhe Jugosllave.

- Autoritetet duhet të sigurojnë që procedurat dhe hetimet e krimeve fillimisht të vëjnë para përgjegjëqsie çdo zyrtar të zbatimit të ligjit që dyshohet të ketë urdhëruar apo kryer shkeljen e drejtave të njeriut.
- Autoritetet duhet të ndërmarrin masa që të sigurojnë se standardet e duhura ruhen gjatë përdorimit të armës policore dhe zbatimit të drejtësisë. Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet përfundimit të keqtrajtimit apo torturimit rutinor të dyshimtëve që ndodhen nën mbikqyrjen e policisë.
- Në bazë të kësaj, autoritetet duhet të sigurojnë që të gjithë anëtarët e forcave të

sigurimit që zbatojnë funksionet ligjore në krahinë e Kosovë janë të njohur dhe të përgatitur t'i aplikojnë standardet e mëposhtme ndërkombetare:

- ◆ Parimet e Kombeve të Bashkuara mbi Përdorimin e Forcës dhe Armëve të zjarrit nga Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit.
- ◆ Parimet e Kombeve të Bashkuarapër Parandalimin Efikas dhe Hetimin e Ekzekutimeve Përmbledhese Ekstra-legale dhe Arbitrare.
- ◆ Kodin e Kombeve të Bashkuara për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit..
- ◆ Grupin e Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave që gjenden ndër Çfarëdo Forme Arrestimi apo Burgosjeje.

- Autoritetet duhet të lejojnë hapjen e një zyreje të terrenit të Komisarit të Lartë për Drejta të Njeriut të Kombeve të Bashkuara (OHCHR), zyre të cilën Komisari i Lartë e ka kërkuar në Prishtinë.

- Autoritetet duhet të lejojnë një mision vëzhgues të drejtave të njeriut, mision të zgjeruar dhe të përkohshëm vëzhgues të të OHCHR-së siç rekomandohet në një letër të Raportuesit Special mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut në Tëritorin e ish-Jugosllavisë, Jiri Dienstbier, që i ka raportuar Komisionit të Drejtave të Njeriut të KB më 14 prill 1998.

- Autoritetet duhet të japin leje për rivendosjen e Misionit Afatgjatë të Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë.

Të gjitha qeverive që marrin pjesë në Kombet e Bashkuara

- Qeveritë pjesëmarrëse duhet të sigurojnë që zyretë terrenit të OHCHR-së në Jugosllavi janë pajisura në mënyrë të përshtatshme që të ballafaqohen me kërkesat që do t'ju shtrohen.